

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KK MAMUSHË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **626-21-027-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **“FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË”**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

MATKOS Pharm SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Shpëtim Rrobaj , Nr. 289, 10 000, Prishtinë

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

044 434 434

(Numri Telefonit)

10 000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Kastriot Vitija

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

matkospharm@gmail.com

(Adresa elektronike)

SH. P. K.
MatkosPharm
PRISHTINE 19

03.03.2022

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë 30.12.2021;
Njoftimi mbi vendimin e AK-së 28.02.2022;

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Kërkesat e përshtatshmërisë 6.4, pika 4 të dosjes së tenderit dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 lidhur me nenin 59 të LPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Pas pranimit të vendimit të AK-së, ne kemi kërkuar qasje në dokumente me datë 28.02.2022. Pas shqyrtimit të dokumenteve të OE të rekomanduar, kemi vërejtur se OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar **“Vërtetimi apo certifikata nga Komuna në të cilën është themeluar biznesi”** për anëtarin e grupit “KEIS (Kosova Export Import Supply Pharmaceutical) SH.P.K. AK në dosje të tenderit, të Kërkesat e përshtatshmërisë 6.4, pika 4 ka kërkuar:

4) Operatori ekonomik duhet të ketë paguar tatimin në pronë në vendin e themelimit të biznesit së paku deri në periudhën e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.	4) Vërtetimi apo certifikata nga Komuna në të cilën është themeluar biznesi .Vërtetimi kërkohej vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet të jete me i vjetër se 60 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes së ofertave.
---	--

Pra sipas kësaj kërke të AK-së duhet që OE të kenë vërtetimin për pagesën e tatimit në pronë në vendimin e themelimit të biznesit deri në datën e hapjes së ofertave. Kurse anëtari i OE të rekomanduar nuk e ka dorëzuar këtë vërtetim apo certifikatë. Andaj në mungesë të këtij vërtetimi, ky grup i OE është i pa përgjegjshëm.

Po ashtu ju si AK tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 të dosjes së tenderit keni kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë realizuar kontrata të ngjashme së paku 270,000.00€ gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit, të njoftimit për kontratë.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Lista e projekteve të realizuara për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë titullin e furnizimeve të përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me “Referencë” ose “Raport” për realizimin me sukses të Kontratës. Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës(transaksioni bankar fatura etj).
---	-----------	---	---

Sipas kërkesës së sipër cekur ju keni kërkuar që operatorët ekonomik duhet të kenë realizuar kontrata të **ngjashme** së paku 270,000.00 euro gjatë tri viteve të fundit. Mirëpo pas analizimit të kontratave të realizuara të grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar rezulton se kontratat e realizuara nga ky grup nuk kanë të bëjnë me furnizim të barnave por pajisjeve apo makinerive mjekësore. Përveç kësaj lideri i grupit posedon vetëm 2 kontrata të realizuara në shumë simbolike prej 4,608.34 euro që kanë të bëjnë me furnizim me barna. Kurse anëtar i tjetër të gjitha kontratat e realizuara i ka për pajisje mjekësore dhe nuk kanë të bëjnë me barna. Pra këto kontrata të realizuara nuk janë të **ngjashme** me këtë tender sepse krejt diçka tjetër janë pajisjet mjekësore dhe krejt diçka tjetër barnat. Rrjedhimisht ju gjatë vlerësimit i keni pranuar këto kontrata si të “**ngjashme**” në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit.

Andaj, kërkojmë që gjatë shqyrtimit të kërkesës për ri-shqyrtim të trajtoni këto pretendime sipas ligjit dhe kërkesave të cilat i keni vendosur në dosje të tenderit me qëllim të vlerësimit të drejtë, ashtu siç është përcaktuar në nenin 59 të LPP-së, dhe të anuloni njoftimin mbi vendimin e AK-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

--

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*